



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:271522

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492603

P.nr.1293/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me bashkëpunëtoren profesionale Arbnije Gashi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, F.L., nga fshati Krajk, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës, Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti përgjithshëm PP/II.nr.1901-15/23 të datës 07.12.2023, në shqyrtimin fillestar, në seancë publike, në prani të prokurorit të shtetit Atnor Skoro, të akuzuarit F.L., dhe mbrojtësit të tij av. M.Sh., më datë 18.03.2024 shpalli, ndërsa me datë 22.03.2024 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari,

F.L., nga i ati dhe e ëma, e gjinisë, i lindur me datë, në fshatin Krajk, Komuna e Prizrenit, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Me datë 10.10.2023, rreth orës 20:20min, në fshatin Krajk, Komuna e Prizrenit, saktësisht afër lumit Drini i Bardhë, i pandehuri F.L., me qëllim të përvetësimit të pasurisë për vete, në mënyrë të kundërligjshme ka shfrytëzuar jashtë mase burimet natyrore duke vepruar në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr. 03/L-163, si dhe Ligjit 04/L-158 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 03/L-163, në atë mënyrë që ditën kritike duke përdorur forcën mekanike dhe kamionin ka gërmuar dhe nxjerr rërë dhe zhavorr, ashtu që i njëjti gjate transportimit të rërës dhe zhavorrit me kamionin e tij të tipit “.....”, me targa regj.është ndaluar nga policia të cilët së bashku me Inspektorët e KPMM-së kanë konstatuar se i pandehuri resurset mineralet i kishte përvetësuar pa leje për aktivitete të veçanta minerare dhe licencë të shfrytëzimit të lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe atë në sasi prej 9.00m³, me ç’ rast me këtë veprim ka shkaktuar dëmtim dhe degradim të ambientit,-

Me këtë ka kryer veprën penale, Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 40, 43, 69, 338 par.1 të KPRK-së, dhe nenin 364 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej treqindedyzet (340) euro, të cilën shumë i akuzuari është e obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjor, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur njëzet (20) euro, për një (1) dite burgim, gjegjësisht shtatëmbëdhjetë (17) ditë burgim.

Refuzohet propozimi i Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, që ndaj të pandehurit të konfiskohet, kamioni i tipit ‘.....’ me targa të regjistrimit, çelësat e kamionit si dhe libreza e qarkullimit të automjetit CRA-....., si mjete të kryerjes së veprës penale dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mjetet t’i kthehen pronarit.

Obligohet të akuzuarit që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në llogari të gjykatës, për paushallin gjyqësor shumë prej njëzet (20) euro dhe në emër të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro të gjitha këto në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë rruga ‘.....’ nr....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e udhëzon në kontest të rregullt juridiko- civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, kësaj Gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1901-15/23 të datës 07.12.2023, kundër të akuzuarit, F.L., nga fshati Krajk, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës, Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 25.01.2024 ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën i akuzuari F.L., pas udhëzimeve të dhëna nga gjyqtari i vetëm gjykues, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, në konsultim me mbrojtësin e tij av. M.Sh., vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohen.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, nga se pranimi i fajësisë është bërë konforme dispozitave ligjore të KPPRK-së, me vullnetin e të pandehurit, duke propozuar që gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë se dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese të cekura si në aktakuzë dhe poashtu në mbështetje të nenit 269 të KPP-së, poashtu ka propozuar që të konfiskohet pasuritë e specifikuar të cekura si në aktakuzë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. M.Sh., ka theksuar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë me vullnet të lirë dhe pas sqarimit të mjaftueshëm për pasojat e pranimit të fajit kërkon nga gjykata që të pranohet pranimi i fajësisë dhe me rastin e marrjes së vendimit kjo të llogaritet si rrethanë lehtësuese nga se i njëjti tani është penduar thellë për veprën që e ka kryer dhe se në të

ardhmen do të jetë me i kujdesshëm, ndërsa sa i përket propozimit për konfiskim, duke pas parasysh se vlera e dëmit është diku 20-30 euro, kërkoj nga gjykata që brenda suazave të ligjit t'ia lirojë kamionin me shënime si në shkresat e lëndës pasi që më nuk do të merret me këtë veprimtari, ndërsa sa i përket masës së dënimit i ka propozuar gjykatës që dënimi të jete sa më i butë.

I akuzuari F.L., ka deklaruar se e pranon në tërësi veprën e cila i vihet në barrë, mbështet fjalët e mbrojtësit të tij duke shtuar se të vetmin burim për krijimin e të ardhurave për familje e ka pas mjetin për të cilin prokuroria ka propozuar që i njëjti të konfiskohet, se me këtë akt do të vështirësohet tej mase mbijetesa e familjes së tij.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 lidhur me 241 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 241 e 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës si: raportin e inspektimit të jashtëligjshëm të resursit mineral me nr. protokollin 11214, i datës 11.10.2023, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës, të dt.10.10.2023, raport për operim ilegal me nr. protokollin 5591 i datës 16.10.2023, urdhëresë për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm mineral nr.000101 datës 11.10.2023, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, të dt.10.10.2023, kërkesë për Urdhër ndalues përfundimtar, e dt.16.10.2023, fotot e bëra në vendin e ngjarjes, ka vërtetuar gjendjen faktike sikur se në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj kjo gjykatë duke u bazuar në këto që u thanë më lart vërtetoi gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarve, plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale, Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338, par.1 të KPRK-së, prandaj dhe u shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që ti kthej pasurinë e sekuestruar përkohësisht të akuzuarve, kamioni i tipit '.....' me targa të regjistrimit, çelësat e kamionit si dhe librezat e qarkullimit të automjetit CRA-....., pasi që nuk është provuar se i njëjti send ka kontribuar direkt në kryerjen e veprës penale, nga ana e prokurorisë, në dispozitiv të aktakuzës nuk është përshkruar mënyra dhe rrethanat mbi të cilat është përdorë mjete në fjalë.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata mori për bazë rrethanat e përcaktuara me nenin 69 të KPRK-së. Gjykata si rrethana rënduese mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale pasi që i njëjti ka vepruar me dashje dhe ka qenë dashur të dinte se mosdhënia e pëlqimit dhe pajtimit mjedisor për eksploatimin në natyrë është aktivitet i kundërligjshëm, rrezikon ambientin mjedisor, përbën vepër penale si dhe intensitetin rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në komunitet, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar:

pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë i njëjti e ka shprehur që në fazat e hershme të procedurës, rrethanat personale se është i gjendje së dobët ekonomike, mbajtës i familjes. Andaj, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit duke menduar se dënimi i shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, e mori në kuptim të nenit 449 dhe 451 të KPPK-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr. 1293/2023, i datës 22.03.2024

Gjyqtari,
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë(30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.